

"Ceremonia me rastin e 15 vjetorit të themelimit të Bankës Qendrore të Kosovës"
Swiss Diamond Hotel,
Salla e konferencës Dyar
15 dhjetor, 2014 nga ora 10:00

Zonja Presidente
Guvernator Hamza
Zonja dhe Zotërinj

- Është një kënaqësi e madhe t'ju drejtohem në këtë përvjetor të rëndësishëm. Do doja të përgëzoj Guvernatorin Hamza, paraardhësit e tij dhe gjithë stafin e BQK-së që kanë bërë një punë të rëndësishme për Kosovën;
- BQK është një institucion progresi puna e mirë e të cilit është pranuar rregullisht në Raportin e Progresit, duke përfshirë edhe atë të fundit;
- Jam veçanërisht i lumtur që përvjetori gjithashtu përkon me periudhën kur pas 6 muajsh të ngërçit politik, Kosova inauguron Qeverinë që shpresojmë se do të jetë në gjendje të zbatojë vendime të rëndësishme që janë para saj.
- Në mesin e atyre më të rëndësishmeve për agjendën dhe perspektivën e BE të Kosovës janë sigurisht përmirësimi i sundimit të ligjit, dialogut për viza, vazhdimi i dialogut me Serbinë dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, Qeverisja Ekonomike.
- Përderisa përgatitja e Programit Kombëtar për Reformë Ekonomike është kryesisht e udhëhequr nga Qeveria, pronësia kombëtare dhe kontributet nga institucionet e pavarura, e veçanërisht BQK, duhet të luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në vitet e ardhshme.
- Unë nuk do të hyj në detajet e sistemit financiar dhe bankar të Kosovës, të mbikëqyrur aq mirë nga BQK.
- Do të doja të theksoj disa nga te arriturat, që unë besoj se, në një masë të madhe janë edhe meritë e BQK-së:
 - Së pari që është dhe më kryesorja, një sistem shumë i qëndrueshëm financiar - veçanërisht vlen të përmendet kur kemi parasysh përvojën e kohëve të fundit, në pjesë të tjera të Evropës dhe të botës;
 - **Së dyti, një sektor bankar likuid dhe amortizuesit e kapitalit** mbi kërkesën e minimumit rregullator;
 - Një rishikim i vazhdueshëm i legjislacionit ekzistues dhe përpjekjet për ta përputhur me **kërkesat e Basel II dhe III**;
 - **Dhe një nga sukseset më të dukshme të kohës së fundit - që ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve të Kosovës** - futja e kodeve SWIFT dhe IBAN për të gjitha llogaritë bankare në 2015: Dëshiroj të theksoj në mënyrë të veçantë se të dyja kodet do të mundësojnë transfere më të lehta

"Ceremonia me rastin e 15 vjetorit të themelimit të Bankës Qendrore të Kosovës"
Swiss Diamond Hotel,
Salla e konferencës Dyar
15 dhjetor, 2014 nga ora 10:00

dhe më të sigurta të parave, transparencë të plotë dhe një luftë më efektive kundër pastrimit të parave.

- Si gjithmonë, Zyra e BE-së është e gatshme të ofrojë ndihmën e saj në të gjitha këto çështje dhe t'i ofroj mbështetje BQK-së në trajtimin e tyre;
- Në lidhje me këtë duhet të theksoj bashkëpunimin e fundit midis BQK-së dhe Bankës Qendrore Evropiane që u mbështet nga fondet e IPA; ne besojmë se ushtrimi ishte jashtëzakonisht i dobishëm në identifikimin e mangësive në sistemin financiar dhe i presim me padurim projektet që do të mënjanojnë këto mangësi.
- Si përfundim, kriza e fundit ekonomike në Europë tregoi se sistemet e qëndrueshme financiare dhe bankare nuk janë vetëm koncepte teorike, por kanë një ndikim të fortë dhe të dukshëm në përditshmërinë e njerëzve.
- Gjatë 15 viteve të fundit, BQK ka bërë një punë të shkëlqyer në ruajtjen e stabilitetit të këtyre sistemeve. Prandaj unë dëshiroj të përgëzoj edhe njëherë Guvernatorin Hamza për përkushtimin dhe kontributin e tij për një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të besueshëm në Kosovë.

Unë mirëpres vazhdimin e bashkëpunimit tonë të mirë, si dhe ia ritheksojmë BQK-së mbështetjen tonë të plotë në arritjen e qëllimeve të rëndësishme që do të sjellin Kosovën edhe më afër BE-së.